



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1931
Nr. _____ Prot

2705
Peshkopi, më _____.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 16


Datë: 28.05.2025

“ Për miratimin e marrëveshjes për programin Grand Assitence For Recycled Equipment Provision(SPJD) mes Bashkisë Dibër dhe organizatës locale Agro-Eko-Dibra.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.429/1 prot.

Peshkopi, më 02.06.2025

Lënda: Për vendimin nr.16, datë 28.05.2025 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.16, datë 28.05.2025 **“Për miratimin e marrëveshjes për programin Grand Assistance For Recycled Equipment Provision (SPJD) mes Bashkisë Dibër dhe organizatës lokale Agro-Eko-Dibra”**, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr.16 Datë 28/05/2025

“Për Marrëveshjen për programin Grand Assistance For Recycled Equipment Provision(SPJD) mes Bashkisë Dibër dhe organizatës Lokale Agro-Eko Dibra”.

Në mbështetje të ligjit nr 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (I ndryshuar), neni 9, pika 1.6, shkronja "a" dhe nenin 64, shkronja "a" dhe "gj". Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar më dt.16.05.2024 midis Bashkisë Dibër dhe organizatës locale Agri-Eko Dibra, në kuadër për programin Grant Assistance For Recycled Equipment Provision (SPJD) për projektin "Modernizing Fire Protection System"(Fire Safe), Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **28.05.2025** me 17 vota pro, 0 kundër dhe 4 apstenim:

VENDOSI

1. Miratimin e Marrëveshjes për programin Grand Assistance For Recycled Equipment Provision(SPJD) mes Bashkisë Dibër dhe organizatës Lokale Agro-Eko Dibra”.
2. Për zbatimin e këtij projekti ngarkohet Drejtoria e Integritit Evropian dhe Ndihmës së Huaj, Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës), Bashkia Dibër.
3. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **28.05.2025**.

Zv/Kryetari i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE NDIHMES SE HUAJ

PROJEKT -VENDIM
Nr. 01 / Date 28 /02 /2025

Për miratimin:

"Marrëveshje për programin Grand Assistance For Recycled Equipment Provision(SPJD) mes Bashkisë Dibër dhe organizatës Lokale Agro-Eko Dibra".

Në mbështetje të ligjit nr 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (I ndryshuar), neni 9, pika 1.6, shkronja "a" dhe nenin 64, shkronja "a" dhe "gj". Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar më dt.16.05.2024 midis Bashkisë Dibër dhe organizatës lokale Agri-Eko Dibra, në kuadër për programin Grant Assistance For Recycled Equipment Provision (SPJD) për projektin "Modernizing Fire Protection System"(Fire Safe).

Kërkojmë:

- 1- Miratimin e Marrëveshjes për programin Grand Assistance For Recycled Equipment Provision(SPJD) mes **Bashkisë Dibër** dhe organizatës Lokale **Agro-Eko Dibra**".

Për Bashkinë Dibër:

Drejtorja E Integrimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj
Z.Ridjan KATA


Drejtorja Financës
Znj.Çeljeta ZUNA

Drejtorja Juridike
Z.Ismet SARAÇI

KRYETARI I BASHKISË
Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me urdhër

Lorenc CIBAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA DIBËR

Relacion mbi Marrëveshjen dhe Aplikimin për Programin SPJD

Në datën 16.05.2024, është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet Bashkisë Dibrë dhe organizatës Lokale Agro-Eko Dibra, në kuadër të aplikimit për programin "Grant Assistance For Recycled Equipment Provision (SPJD)" për projektin MODERNIZING Fire Protection System (Fire Safe). Ky aplikim është bërë në partneritet me organizatën Agro-Eko Dibra për realizimin e projektit të modernizimit të sistemit të mbrojtjes nga zjarri në Bashkinë Dibrë.

Në përputhje me këtë marrëveshje, si dhe amendimin e saj, me nr. 1778/1 prot., datë 04.06.2024, është theksuar se çdo ndryshim ose amendament i mëtejshëm duhet të jetë i shkruar dhe i konfirmuar nga palët respektive. Ky përcaktim është në përputhje me pikën 6 të marrëveshjes, e cila parashikon procedurat për ndryshime të mundshme.

Bashkia Dibrë ka aplikuar pranë Ambasadës Japoneze për marrjen e një mjeti zjarrfikës përmes programit SPJD, duke bashkëpunuar me organizatën Agro-Eko Dibra. Ky aplikim është bërë në përputhje me rregullat e programit SPJD, ku Bashkia Dibrë, si institucioni aplikues, ka nënshkruar një marrëveshje me organizatën Agro-Eko Dibra, e cila ka rol të rëndësishëm në realizimin e këtij projekti.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se Bashkia Dibrë ka përfutur nga Ambasada Japoneze një ndihmë për një makinë teknologjike të menaxhimit të mbetjeve, e sipas rregullave të donarit brenda 2 viteve nuk mund të dhurojë donacion të dytë në mënyrë të drejtperdrejtë tek Bashkia pa u mbyllur faza e vlerësimit në fund të 2 vjeçarit. Nisur nga kjo Bashkia ka aplikuar nepermjet programit SPJD me partnere një organizatë, për sigurimin e mjetit zjarrfikës duke përforcuar kështu angazhimin e saj për zhvillimin e infrastrukturës dhe mbrojtjes mjedisore. Ky projekt është i përfshirë në marrëveshjen e përshkruar dhe amendamentin përkatës.

Sipas marrëveshjes dhe amendamentit të lidhur, janë parashikuar detajet për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella mes Bashkisë Dibrë dhe organizatës Agro-Eko Dibra. Ky bashkëpunim ka për qëllim përmirësimin e sistemit të mbrojtjes nga zjarri në rajonin e Dibrës dhe garantimin e sigurimit të jetës dhe pasurisë për qytetarët.

Në përfundim, pas përmbushjes së të gjitha hapave të parashikuar në aplikim dhe realizimin e projektit, mjeti zjarrfikës do të kalohet Bashkisë Dibrë nga Organizata Agro-Eko Dibra, si dhuratë nga Ambasada Japoneze, në formën e një granti. Ky proces është një hap i rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës dhe mbrojtjes së qytetarëve të Bashkisë Dibrë.

Drejtoria Integrimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj

Ridjan KATA



Bashkia Dibër

11R-1778

Peshkopi, më 16.05.2024



AgroEko DIBRA

Agro – Eko Dibra

Peshkopi, më 15 / 05 / 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Nënshkruar në Peshkopi më datë 15.05.2024

Ndërmjet:

Bashkisë Dibër

Institucion i Vetëqeverisjes Vendore.

i përfaqësuar nga: Z. Rahim Spahiu, Kryetar i Bashkisë Dibër,

dhe

Agro – Eko Dibra

i përfaqësuar nga: Z. Maksim Hajrullai, Drejtor Egzekutiv i Agro-Eko Dibra,

që në këtë marrëveshje do të quhen “Palët”,

Palët bien dakord për sa më poshtë:

1. Objekti i marrëveshjes

1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i parimeve dhe procedurave të bashkëpunimit si dhe i detyrimeve të ndërsjella të Palëve, në kuadër të bashkëpunimit për projektin Modernizing Fire Protection System "Fire Safe".
2. Për më tepër, kjo marrëveshje përcakton edhe kërkesat ndaj palëve për administrimin me korrektësi të këtij projekti të financuar në kuadër të programit SPJD.

2. Afati i Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

1. Marrëveshja e Partneritetit midis Bashkisë Dibër dhe Agro-Eko Dibra, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të gjitha Palët.
2. Zbatimi faktik i Marrëveshjes fillon që në fazat paraprake të realizmit të konsultimeve rreth përmirsimit të shërbimit Zjarrfikës në Territorin e Bashkisë Dibër.

3. Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Dibrë

1. Të jetë përgjegjëse e drejtpërdrejtë për administrimin e aseteve të dhuruara për shërbimin zjarrfikës nga Agro – Eko Dibra.
2. Të vërë në dispozicion të Agro-Eko Dibra Planet dhe Projektet për përmirësimin e shërbimit zjarrfikës.
3. Të koordinoj dhe bashkëpunoj në mënyrë të ngushtë me Agro-Eko Dibra për implementimin e projektit si dhe të financojë kostot administrative si transport, zhdoganim apo edhe kolaudimin e makinës me një kosto prej 16 500 Euro.
4. Kostot si më poshtë:

Item	Unit Price	Quantity	Total Price	Note
Project coordinator	800	1	800	Project implementation coordinator for the 6-month period
Transport	10,000	1	10,000	Logistical Company Service
Customs Payment	2,500	1	2,500	Customs Payment
Other administrative Services for Car	600	1	600	Insurance Car Inspection Administrative procedures
Activities with youths	1,200	1	1,200	Cost of Activity
Sheets - leaflets, posters, tables for support	400	1	400	Sheets - leaflets, posters, tables for support
Auditing Service	1,000	1	1,000	Cost of Auditing
Total			16,500	

4. Të drejtat dhe detyrimet e Agro-Eko Dibra

1. Ti japi në përdorim Bashkisë Dibrë mjetin zjarrfikës e marrë në kuadër të programit SPJD.
2. Të mbështesë me asistencë teknike dhe profesionale Bashkinë Dibrë, në ngritjen e kapaciteteve profesionale në këtë fushë.
3. Të ofrojë ekspertë dhe përvojë në organizimin e veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit bazuar në eksperiencën e tyre.

5. Konflikti i interesit

1. Në këtë Marrëveshje, konflikti i interesave përfaqëson çdo rrethanë që ka ndikuar apo mund të ndikojë në zbatimin e Marrëveshjes nga palët, në mënyrë objektive dhe të paanshme. Të tilla rrethana mund të vijnë si rezultat i interesave ekonomike, preferencave politike apo kombëtare apo lidhjeve familjare.
2. Palët kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim shmangien e çdo konflikti interesi dhe të informojnë njëri tjetrin, deri në 5 (pesë) ditë nga evidentimi i këtij konflikti, për çdo rrethanë që ka sjellë apo mund të sjellë një konflikt të tillë interesi.

6. Ndryshimet në marrëveshje

1. Çdo ndryshim e modifikim i kësaj Marrëveshjeje Partneriteti të Projektit do të bëhen vetëm në formën e një shtojce të marrëveshjes, dhe do të pranohet e nënshkruhet nga të gjitha palët e kësaj Marrëveshjeje.

7. Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Marrëveshja përfundon pas mbylljes të projektit.

8. Hyrja në fuqi e marrëveshjes

1. Marrëveshja hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

9. Regullimet e marrëveshjes

1. Secila palë ka të drejtë të ndërpresë marrëveshjen duke paraqitur një lajmërim me shkrim të paktën gjashtë muaj para afatit.


Bashkia Dibër:

Kryetari i Bashkisë

Z. Rahim SPAHIU

Vula

Firma




Agro-Eko Dibra:

Drejtori Ekzekutiv

Z. Maksim Hajrullai

Vula

Firma





Bashkia DIBER

Nr. 2778/1 - Prof

Agro-Eko-Dibra

Peshkopi, me

04.06.2024

Peshkopi, me 04.06.2024

AMENDIMI I MARREVESHJES SE BASHKEPUNIMIT

BASHKIA DIBER

DHE

AGRO-EKO DIBRA

Referuar Marrëveshjes se nenshkruar ne daten 16.05.2024, midis Bashkise Diber dhe organizates Lokale Agro-Eko DIBRA, ne kuader te aplikimit per programin Grant Assistance For Recycled Equipment Provision (SPJD) per projektin *MODERNIZING Fire Protection System*(Fire Safe), bazuar ne piken 6(gjashte)te marreveshjes per (Ndryshimet ne Marrëveshje)eshte e rendesishme ndryshimet ne marreveshje dueht te jene te shkruara dhe konfirmuara nga te dyja palët.

Bazuar ne marrëveshjen e mëparshme palët bien dakort për të bërë disa ndryshime në pikën e 3 të marrëveshjes :

3.Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Dibër

- 1.Të jete përgjegjëse e drejteperdrejt per administrimin e aseteve te dhuruara per sherbimin zjarrfikës nga Agro-Eko DIBRA .
- 2.Të vëre ne dispozicion të Agro –Eko Dibra Planet dhe Projektet për përmirsimin e shërbimit zjarrëfikës.

3. Të kordinoj dhe bashkëpunoj në mënyre te ngushte me Agro –Eko Dibra për implementimin e projektit si dhe të financojë kostot administrative si transport ,z apo koalidimin etj me nje kosto prej 270 000 Lek.

Kostot si më poshtë

Item	Unit Price	Quantity	Total Price	Note
Project coordinator	80 000	1	80 000	Project implementation coordinator for the 6-month period
Other administrative Services for car	50 000	1	50 000	Insurance Car Inspection Administrative Procedures
Activities with youth	120 000	1	120 000	Cost of Activity
Sheets – leaflets,posters,table for suppot	20 000	1	20 000	Sheets – leaflets,posters,table for support
TOTAL			270 000	

Bashkia Diber :

Kryetari I Bashkisë

Z.Rahim SPAHIU

Në mungesë dhe me urdhër

Zv.Kryetar

Ruzhdi DEPA

Vula

Firma

Agro-Eko DIBRA :

Drejtori Ekzekutiv

Z.Maksim Hajrullai

Vula

Firma